



REPUBLIKA E SHQIPËRISË



UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS
SENATI AKADEMIK

Nr. 957/16 Prot.

Tiranë, më 18/04 /2023

VENDIM

Nr. 11, datë 18.04.2023

PËR

**MIRATIMIN E PROJEKTEVE KËRKIMORE-SHKENCORE, PROPOZUAR PËR
PROGRAMIN E STUDIMIT TË CIKLIT TË TRETË “DOKTORATË” NË INXHINIERI
FIZIKE, TË RIORGANIZUAR, NË FAKULTETIN E INXHINIERISË MATEMATIKE
DHE INXHINIERISË FIZIKE, NË UNIVERSITETIN POLITEKNIK TË TIRANËS**

Mbështetur në Ligjin Nr. 80/2015, datë 22.07.2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", Vendimin Nr. 41, datë 24.01.2018, "Elementet e programeve të studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë", VKM Nr. 879, datë 18.12.2019, VKM Nr. 185, datë 25.03.2021, "Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin Nr.41, datë 24.01.2018", Udhëzimeve të MAS Nr. 1, datë 14.01.2020 dhe Nr. 7, datë 31.03.2021, "Për dokumentacionin dhe procedurat për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e institucionit të Arsimit të Lartë, degëve të tyre, njësive kryesore dhe programeve të studimit si dhe për ndarjen ose bashkimin e Institucionit të Arsimit të Lartë" i ndryshuar, kërkesën e Fakultetit të Inxhinierisë Matematike dhe Inxhinierisë Fizike dhe Rregulloren e Studimeve të Doktoratës të UPT-së, Senati Akademik në mbledhjen e datës 18.04.2023,

VENDOSI:

Të miratojë projektet kërkimore-shkencore me titull:

1. Vetitë fizike të çelikut të zinkuar me metodë termike dhe qëndrueshmëria e tij ndaj korrozionit;
2. Monitorimi i fushës elektromagnetike të frekuencave të larta në zonat urbane të Tiranës, dhe krijimi i një sistemi hartash tematike si pjesë integrale për vizualimin e rezultateve;
3. Modelimi dhe vlerësimi i niveleve të radonit dhe rekomandimet për planet e veprimit në Shqipëri dhe Kosovë;
4. Përdorimi i imazheve HD të PET/CT në radioterapi; Korrelimi i tyre me MRI dhe CT;
5. Zhvillimi i modeleve të simulimit e parashikimit dhe integritimit me databazën TCIA të imazheve mjekësore;
6. Komplementariteti i burimeve të rinovueshme të energjisë, dielli dhe era në Shqipëri; Modelimi statistikor, metrikat dhe aplikime të tyre;
7. Kontrolli i cilësisë në radioterapinë konvencionale krahasuar me teknikat moderne të radioterapisë;

Propozuar për programin e studimit të ciklit të tretë “Doktoratë” në Inxhinieri Fizike, të riorganizuar, në Fakultetin e Inxhinierisë Matematike dhe Inxhinierisë Fizike, në Universitetin Politeknik të Tiranës.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

Prof. Dr. Andrea Maliqari

